

# **PARTIA KOMUNISTE E SHQIPËRISË (PKSH)**

## **HISTORIKU**

Partia Komuniste e Shqipërisë (PKSH) u formua në vitin 1991 si një fraksion i Partisë së Punës së Shqipërisë (PPSH) nga Hysni Milloshi, i cili ishte një figurë publike e njohur si shkrimtar gjatë periudhës socialiste të Shqipërisë dhe që me shkrimet e tij mbështeste kultin e personalitetit të diktatorit Enver Hoxha. Ai krijoi organizatën 'Vullnetarët e Enverit' në Berat më 12 shkurt 1991, duke përfaqësuar vijën e ashpër të PPSH-së, e cila gjatë kësaj kohe kërkonte që të reformohej dhe të linte pas figurën e Hoxhës. PKSH e themeluar nga Hysni Milloshi vazhdoi që të udhëhiqej nga ai deri me vdekjen e tij në vitin 2012 në Tiranë. Duhet theksuar që Nexhmije Hoxha, e veja e Enver Hoxhës ishte gjithashtu anëtare e Partisë Komuniste të themeluar nga Hysni Milloshi. Më 16 korrik 1992, parlamenti shqiptar votoi që të ndalohej kjo parti dhe gazeta që publikohej prej saj. Ndërkohë që një ligj i miratuar në qershor të vitit 1992 iu lejonte kryetarëve të partive politike që të posedonin armë, dhe në kohën që partia komuniste u nxorr jashtë ligjit, Hysni Milloshi u arrestua më 22 korrik 1992 për armëmbajtje pa leje. Në vitin 1998 u hoq ndalesa për regjistrimin e partive të ekstremit të majtë, dhe në këtë mënyrë PKSH u regjistrua në Komisionin e Zgjedhjeve. Vetë PKSH me kalimin e viteve pësoi disa largime nga partia dhe krijimin e partive të tjera komuniste simotra. Në vitin 2002, një fraksion i PKSH-së u shkëput për të rithemeluar Partinë e Punës Shqiptare. Por gjithashtu ka pasur dhe përpjekje të vazhdueshme për unifikimin e tyre. Kështu gjatë vitit 2006 u mbledh një kongres unifikues ku morën pjesë rreth 300 anëtarë të partive të vogla komuniste. Gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2005 partia fitoi 8901 vota në listën proporcionale ose 0.7% të votave të përgjithshme. Këto shifra nuk i mundësonin përfaqësimin në Kuvendin e Shqipërisë. Në zgjedhjet e vitit 2003 e 2007 PKSH ka përkrahur PS-në dhe kandidatët e saj në zgjedhjet përkatëse. Por në vitin 2011 ajo dëbohet nga koalicioni i majtë i PS-së, ndaj në zgjedhjet vendore PKSH vendos të kandidojë e vetme duke nxjerrë kandidatin e tretë për Tiranën Hysni Milloshin, përballë Lulzim Bashës dhe Edi Ramës. Sidoqoftë, në zgjedhjet parlamentare të vitit 2013 elektorati i tyre ra në mënyrë të ndjeshme, duke marrë vetëm 899 vota në të gjithë vendin. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017, PKSH mori 1029 vota ose 0.07% të votave gjithsej. Pas largimit të jeta të Hysni Milloshit në vitin 2012, krye të PKSH është zgjedhur Qemal Cicollari, për të cilin nuk është e publikuar ndonjë e dhënë në lidhje me jetëshkrimin por ka një aktivitet të dukshëm dhe aktiv të shkrimeve politike që paraqesin ideologjinë e partisë që ai përfaqëson.

**KRYETARI - Qemal Cicollari**